

Rimendimi për mbetjet

Studimi bazë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në rajonin jugperëndimor dhe rajonin e Pellagonisë

SALAR International
A part of the Swedish Association of Local Authorities and Regions

Autorët:

Emill Angellov, Lideri i ekipit

Bojana Stanojevska Pecurovska, Eksperte lokale për menaxhimin e mbetjeve

Ekipi redaktues:

Helena Ohlsson, Menaxhere e projektit

Mohamed Al Kamil, zlvendësmenaxher i projektit

Tomas Najlund, ekspert ndërkombëtar për menxhimin e mbetjeve

Dizajni i publikimit

Stanislava Sharoviç Pavkoviç, Drejtore e artit

Ky është një version i shkurtër i studimit fillestar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në rajonin Jugperëndimor dhe rajonin e Pellagonisë, i zhvilluar në fund të vitit 2022 gjatë fazës fillestare të projektit të Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve në nivel lokal.

SALAR International ka bërë përpjekje të arsyeshme që të dhënat, analizat, mendimet dhe informatat tjera të përdorura në Plan të jenë të sakta. Edhepse ata janë mbledhur nga burime që besohet se janë të besueshme, SALAR International e pranon se saktësia e të dhënave ose forma e përdorur nuk mund të garantohet. Plotësia dhe saktësia e të gjiithë të dhënave dhe informatave të përdorura për të prodhuar këtë raport varet nga burimet e të dhënave dhe informatave të tilla, që janë jashtë kontrollit të SALAR International.

SALAR International dëshiron të falenderojë të gjithë institucionet dhe individët që kanë marrë pjesë në studim për mbështetjen dhe kontributin pa rezervë. © SALAR International, 2023. Të gjithë të drejtat e rezervuara.

Rimendimi për mbetjet

Studimi bazë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në rajonin jugperëndimor dhe rajonin e Pellagonisë

SHKURT 2023

Hyrje

Rritja e zhvillimit ekonomik dhe modelet gjithnjë e në zhvillim të konsumit rrisin prodhimin e mbetjeve dhe komplikojnë përbërjen e mbetjeve. Ky është një fenomen mbarëbotëror dhe Maqedonia e Veriut nuk është një përjashtim. Situata e menaxhimit të mbetjeve në Maqedoni mund të karakterizohet se është nën standardet e parapara, e pamjaftueshme dhe joefektive që rezulton me efekte negative në mjedisin jetësor dhe shëndetin publik.1 Janë ndërmarrë hapa për të korrigjuar situatën me zhvillimin e sistemit Rajonal të menaxhimit të mbetjeve dhe planeve përkatëse (PRMM) për rajonet planore në vitin 2016. Edhe objektivat nacionale më pak ambicioze kërkojnë një reduktim drastik të sasisë të përgjithshme të mbetjeve komunale që shkojnë në deponi dhe një rritje të proporcioneve të përgatitura për ripërdorim ose riciklim.


Ky studim bazë synon të ofrojë një analizë më të nuancuar të dobësive institucionale të identifikuara në zbatimin e politikave të menaxhimit të mbetjeve në vend. Ai gjithashtu paraqet një pasqyrë të situatës së përgjithshme me shërbimet komunale të menaxhimit të mbetjeve dhe perceptimin e publikut për çështjet e mbetjeve në të dy rajonet e projektit – rajoni i Pellagonisë dhe rajoni jugperëndimor.

Metodologjia

- Shqyrtimi i dokumentit
- Anketa e opinionit publik
- Anketa e administratës komunale/ndërmarrjeve komunale publike
- Intervistat

[1] Strategjia për menaxhim të mbetjeve në Republikën e Maqedonisë (2008-2020) - https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2014/12/Waste-Management-Strategy-of-the-RM-2008-2020.pdf

Harta e rajoneve të projektit



Rajoni jugperëndimor

Populllsia: 177,398
Komuna: 9
Urbane: 52.2%
Rurale: 47.8%

Pellagonia

Populllsia: 210,431
Komuna: 9
Urbane: 59,9%
Rurale: 30,1%

Burimi: Regjistrimi i vitit 2022.

Të dhënat kryesore të nxjerra nga ky studim



99.7%

E MBETJEVE TË GRUMBULLUARA PËRFUNDOJNË NË DEPONI



82%

TË POPULLSISË I OFROHEN SHËRBIME TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE ME MBULIM DUKSHËM MË TË ULËT NË ZONAT RURALE



PIKAT E SELEKTIMIT SË MBETJEVE JANË TË DISPONUESHME PËR

32%

TË POPULLSISË NË RAJONE. KY NUMËR ËSHTË ULUR NË 16.5% NË ZONAT RURALE

QASJE NË SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE NË ZONAT RURALE KANË

62.4%

E BANORËVE,



NË KRAHASIM ME

94.5%

TË POPULLSISË NË QENDRAT URBANE

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET E SELEKTIMIT TË MBETJEVE NË TË DY RAJONET ËSHTË MJAFTË E LARTË NË NIVEL PREJ


54%

(KRAHASUAR ME SHËRBIMET E TJERA PUBLIKE)

MENAXHIMI I MBETJEVE ËSHTË ÇËSHTJA E TRETË ME PRIORITET NË RAJONE PAS RRUGËVE TË KËQIJA LOKALE DHE QENVE ENDACAKË

VETËM **7%**

E TË ANKETUARVE NGA ADMINISTRATA KOMUNALE DHE NDËRMARRJET KOMUNALE DEKLARUAN SE PËRDORIN TË DHËNA TË NDARA SIPAS GJINISË PËR PLANIFIKIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE



63%

DHE

43%

MBETJEVE TË MËDHA DEPONOHEN NË MËNYRË TË PARREGULLT NË RAJONIN JUGPERËNDIMOR DHE RAJONIN E PELLAGONISË.



87%

DHE

77%

E NDËRTIMEVE/RRËNIMEVE JANË DEPONUAR NË MËNYRË TË PARREGULLT NË RAJONIN JUGPERËNDIMOR DHE RAJONIN E PELLAGONISË.

Praktikat e menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal

Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve në rajonin e Pellagonisë dhe ragonin jugperëndimor ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale. Shërbimet i ofrohen 82% të popullsisë dhe pajisjet dhe automjetet e grumbullimit të mbetjeve mezi përmbushin kërkesat teknike dhe nevojat e popullsisë. Situata është më e keqe në zonat rurale. Ka një mospërputhje të dukshme ndërmjet mbetjeve të krijuara të vlerësuara në rajone dhe sasisë së mbetjeve të grumbulluara të raportuara nga komunat. Sipas të dhënave, rajoni i Pellagonisë arrin të grumbullojë rreth 80% të mbetjeve të krijuara, ndërsa për rajonin jugperëndimor ky numër ka qenë rreth 50% për vitin 2017 dhe 2018 dhe ka rënë në më pak se 30% në vitet në vijim.

Sfidat kryesore

- Nuk ka sistem formal të grumbullimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit në rajonin e Pellagonisë dhe rajonin jugperëndimor
- Praktikat e vendosura të grumbullimit të mbetjeve dhe performanca e ndërmarrjeve në të dy rajonet rezulton në një numër të madh të deponive. PRMM nga viti 2016 kanë identifikuar 109 deponi në rajonin e Pellagonisë dhe 85 të tjera në rajonin jugperëndimor.
- Vjetërsia mesatare e mjeteve të grumbullimit të mbetjeve është mbi 25 vjet. Prishjet dhe mirëmbajtja e shpeshtë krijojnë probleme me oraret e grumbullimit të mbetjeve
- Pagesa për grumbullimin e mbetjeve (për ekonomi familjare) varion dukshëm ndërmjet komunave dhe atë nga 50 në 250 MKD (0.8 – 4 EURO). Shkalla e raportuar e mbledhjes së pagesave për familjet gjithashtu varion nga 60% (Plasnicë) dhe 82% (Manastir).


Planifikimi rajonal i menaxhimit të mbetjeve

PRMM-të janë dokumente për politika që ofrojnë një kornizë strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta të krijuara në çdo rajon. Deri në fund të vitit 2016, të gjitha rajonet planore kanë pranuar PRMM-në e tyre. Një analizë e vitit 2020 për Bankën evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH) rekomandoi bashkimin e rajonit jugperëndimor me rajonin e Pellagonisë, dhe rajonin e juglindjes me rajonin e Vardarit për të arritur ekonominë e nevojshme të shkallës.

Si pjesë e PRMM, komunat mbajnë përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin dhe zbatimin e menaxhimit të mbetjeve dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të shërbimeve publike, të cilat mbeten ofruesit kryesorë të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Për menaxhimin e deponive rajonale, do të krijohen ndërmarrje ndërkomunale për menaxhimin e mbetjeve nga bordet ndërkomunale të menaxhimit të mbetjeve. Kështu krijohet një dallim i qartë ndërmjet planifikimit/kontraktimit dhe funksionimit që duhet të rezultojnë në transparencë më të madhe dhe efikasitet më të lartë të shpenzimeve.

PRMM-të njohin sfidat kryesore të sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve – mbipunësimin dhe mungesën e kualifikimit në shërbimet publike, deficitin në planifikim dhe monitorim, norma të ulëta të mbledhjes së pagesave, performancë dhe monitorim të pamjaftueshëm të shpenzimeve, grumbullim joefikas dhe deponim që nuk kontrollohet mjaftueshëm dhe mbulim i kufizuar i zonave rurale/të largëta – dhe propozoni disa skenarë për përmirësime.

Përfundimet



Decentralizimi

Decentralizimi në Maqedoninë e Veriut ka qenë institucional, jo funksional. Një numër i madh i institucioneve publike janë transferuar në institucionet lokale, por pushteti qëndror ka mbajtur një kontroll të konsiderueshëm mbi këto institucione. Sistemi i pengon institucionet lokale të përshtasin dhe racionalizojnë strukturën organizative dhe funksionimin e duhur të disa prej institucioneve të decentralizuara. Si rrjedhojë, zbatimi i politikave rezulton me kompetenca të pa ushtruara, pakënaqësi të qytetarëve me shërbimet e ofruara dhe borxhe të konsiderueshme (borxhe të papaguara), që në shumë raste ka sjellë bllokimin e llogarive. Kjo ndikon në sjelljen e pushtetit qëndror dhe lokal dhe shkakton mungesë të efikasitetit.



Menaxhimi i të dhënavee

Mbledhja dhe analiza e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve është sporadike, jokonsistente dhe përdoret rrallë për qëllime të vendimmarrjes. Shumica e të dhënave të menaxhimit të mbetjeve janë vlerësime që nuk janë koherente dhe të vlerësuara. Vetëm rreth një e treta e komunave raportojnë të dhëna vjetore për mbetjet e ngurta komunale të transportuara dhe të deponuara në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (MMJPH), pavarësisht detyrimeve ligjore. Të dhëna të besueshme nevojiten për të mbështetur organizimin e grumbullimit të mbetjeve, për planifikimin e kapaciteteve të infrastrukturës dhe për të matur performancën kundrejt objektivave. Për më tepër, mungesa e të dhënave të besueshme i pengon kapacitetet komunale për të bërë llogaritjet e duhura ekonomike dhe planifikimin e menaxhimit të mbetjeve.



Sistemi rajonal i menaxhimit të mbetjeve

Inkorporimi i sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve i la komunat pa një ndjenjë reale të pronësisë dhe me shumë pak kuptim të qëllimit të përgjithshëm të PRMM-ve dhe ndryshimeve të nevojshme në praktikat dhe qëndrimet. Kjo krijon mosbesim dhe skepticizëm për zbatimin e planeve që është në fund të listës së prioriteteve në nivel lokal. Mjedisi jetësor është dëshmuar të jetë një prioritet i ulët për shumicën e komunave, dhe shumë komuna nuk kanë sektor të mjedisit jetësor dhe kompetencat mjedisore shpesh anashkalohen. Kuptimi i komunave për menaxhimin e mbetjeve është kryesisht reaksionist në natyrë – ai përfshin grumbullimin dhe deponimin. Natyra komplekse e menaxhimit të mbetjeve që përfshin ndjekjen e trendeve të popullatës dhe gjenerimit të mbetjeve, bërjen e parashikimeve, vendosjen e objektivave dhe arritjen e tyre, komunikimin me publikun dhe rritjen e vetëdijes publike duket se janë diçka që nuk janë kuptuar plotësisht në nivel lokal.



Ofrimi i shërbimit universal

Në një kontekst të ngjashëm, nocioni i shërbimit universal është anashkaluar kryesisht nga ndërmarrjet komunale dhe administrata në përgjithësi (mbulimi i popullsisë është mesatarisht 82%). Ofrimi i shërbimeve komunale bazë për çdo banor në territorin e tyre tregtohet lehtësisht për shpenzime më të ulëta operative dhe funksionim më të thjeshtë. Ata që mbeten pas janë segmentet më të rrezikuara të popullsisë që vuajnë edhe përjashtimin në fronte të tjera.


Numri i stafit të ndërmarrjeve në disa komuna duket në mënyrë disproporcionale i madh në krahasim me madhësinë e territorit dhe popullsisë që mbulojnë. Kjo i bën ndërmarrjet me staf të tepërt dhe të pakualifikuar për ofrimin e shërbimeve komunale cilësore. Kjo mund të jetë një pengesë serioze në përpjekjen për të futur çdo ndryshim organizativ që synon përmirësimin e efikasitetit dhe sigurimin e ofrimit efektiv të shërbimeve.



Financimi i menaxhimit të mbetjeve

Ekziston një pabarazi e madhe në zhvillim dhe stabilitet financiar të komunave të ndryshme në rajone. Me disa përjashtime, shumica e tyre janë shumë të zhytur në borxhe dhe mezi ofrojnë shërbimet e kërkuara. Kombinimi i rënies së popullsisë, mbledhjes së dobët të pagesave (faturave) dhe mungesës së përgjithshme të kapaciteteve i bën ata të pafuqishëm në përmirësimin e situatës.

Tarifa e pagesesës për grumbullimin e mbetjeve është shumë e ulët dhe varion nga 50 – 250 MKD (0,8 – 4 EUR) dhe tarifa e raportuar e mbledhjes së mbetjeve për familjet gjithashtu varion ndërmjet 60% dhe 82%. Kjo nuk është rregulluar prej dekadash dhe kombinimi i të dyjave i vë një barrë të rëndë gjendjes financiare të ndërmarrjeve publike komunale. Përcaktimi i tarifës të pagesave respektivisht faturave për menaxhimin e mbetjeve nuk është i bazuar në treg dhe çështja e rregullimit të tyre ka qenë shumë e politizuar në të kaluarën dhe konsiderohet një veprim jopopullor.



Mendimet gjinore dhe të drejtat e njeriut

Duke qenë më afër komuniteteve lokale, komunat kanë përgjegjësinë dhe pushtetin për të zbatuar parimin e barazisë gjinore dhe qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në hartimin dhe ofrimin e shërbimeve publike. Studimi zbuloi se ka mungesë të të kuptuarit të rëndësisë së integrimit gjinor dhe mungesë kronike të të dhënave të ndara gjinore. Më pak se 7% e stafit komunal deklaruan se përdorin të dhënat gjinore për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve.

Ka një mbulim më të ulët me grumbullimin e mbetjeve në zonat rurale dhe në mesin e disa komuniteteve etnike, sipas studimit, qasja në shërbimet e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale është 62.4%, ndërsa 94.5% në qendrat urbane. Kënaqshmëria me shërbimet e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale është gjithashtu më e ulët (45%) krahasuar me ato në qytete (59%). Komunat nuk janë thjeshtë ofrues të shërbimeve, por edhe bartës të detyrave dhe shpeshherë duhet t‘u kushtojnë vëmendje të veçantë, në varësi të fushës së politikave, të drejtave të grupeve të veçanta të njerëzve.

Rekomandime

Qëllimi i këtij studimi ishte të jepte një pamje të situatës së menaxhimit të mbetjeve në vend dhe të zhvillonte tregues të performancës që do të ndihmonin në matjen e suksesit të projektit. Në bazë të gjetjeve, ofrimi i përmirësuar i shërbimit duhet të vijë përmes planifikimit më efektiv, procesit sistematik të identifikimit dhe përhapjes së praktikave më të mira dhe koordinimit më të mirë ndërmjet niveleve të qeverisjes për të lejuar lokalizimin efektiv të politikave të menaxhimit të mbetjeve.

- Komunikimi i asaj që funksionon më mirë me palët e tjera të interesit është i rëndësishëm – praktikat më të mira duhet të identifikohen dhe të regjistrohen sistematikisht dhe të mblidhen në një formë të një udhëzuesi praktik për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. Rrjetet dhe kapacitetet e Bashkësisë të njësive të vetëqeverisjes lokale (BNJVL) në ofrimin e trajnimeve duhet të shfrytëzohen për komunikimin dhe përhapjen e praktikave më të mira në komunat në vend.

- Struktura koordinuese efektive për realizimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve duhet të ekzistojë ndërmjet MMJPH, qendrave të zhvillimit rajonal dhe komunave për të arritur një koordinim efektiv, monitorim dhe zbatim të menaxhimit të mbetjeve në vend. Ndarja e qartë e roleve dhe proceseve funksionale duhet të identifikohet dhe të caktohet për të lejuar përkthimin e politikave nacionale të zhvillimit në plane operative lokale dhe zbatimin efektiv të tyre.

- Duhet të bëhen përpjekje për të krijuar një sistem të thjeshtë por funksional të menaxhimit të të dhënave për mbetjet, i cili do të ndihmojë komunat dhe ndërmarrjet publike të ndjekin më mirë trendet dhe të zhvillojnë praktika që kanë natyrë parandaluese dhe jo reaktive. Duhet të identifikohen pikat ekzistuese të grumbullimit të të dhënave, (mungesa) e interoperabilitetit të sistemeve të ndryshme të informacionit dhe praktikave analitike dhe duhet të ofrohen zgjidhjet e duhura për të tejkaluar hendeqet.

- Për të lejuar një koordinim më të mirë të aktiviteteve të lidhura me gjininë, përfshini aspektin gjinor në ofrimin e shërbimeve rutinore të menaxhimit të mbetjeve dhe pronësinë e sigurt të grupit më të gjerë të palëve të interesuara, duhet të konsultohet Udhëzuesi për integrimin gjinor në ndërrmarrjet publike i përgatitur nga Rrjeti i asociacioneve të institucioneve lokale të Evropës juglindore (NALAS).

- Të gjitha këto aktivitete duhet të realizohen përmes qasjeve pjesëmarrëse dhe të ndihmojnë komunat të ofrojnë mundësi më të mëdha për banorët që të marrin pjesë dhe të shprehin mendimet dhe preferencat e tyre për çështjet e lidhura me mbetjet. Pjesëmarrja, nëse trajtohet mirë, mund të çojë gjithashtu në përmirësimin e besimit, i cili nga ana tjetër është një faktor pozitiv për zhvillimin ekonomik lokal dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve. Duhet të merren parasysh dhe të zbatohen aktivitetet e vazhdueshme për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbetjeve duhet të merren parasysh, sa herë që planifikohen aktivitete të lidhura me mbetjet.

SALAR International

Projekti i financuar nga Sida “Menaxhim i qëndrueshëm i mbetjeve në nivel lokal” realizohet nga SALAR International në bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Ministrinë e vetëqeverisjes lokale dhe Bashkësinë e njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.